



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**Raport i punës së**  
**Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës**  
**për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**për vitin 2015**

Prishtinë  
Shkurt 2016

**TABELA E PËRMBAJTJES:**

	Fjalë hyrëse e kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	3
1.	Përmbledhje ekzekutive	5
2.	Korniza ligjore	6
3.	Fushëveprimi i Këshillit	7
4.	Organizimi i Këshillit	7
5.	Aktivitetet e Këshillit për periudhën raportuese	9
5.1.	Funksioni i shqyrtimit të ankesave	9
5.1.1	Ankesat e pranuar sipas objektit	9
5.1.2	Ankesat e pranuar sipas strukturës gjinore të ankueseve	11
5.1.3	Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankueseve	12
5.1.4	Ankesat e pranuar sipas institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë	13
6.	Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve	15
6.1	Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore	15
6.2	Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale	20
7.	Ndarja e ankesave sipas formës së vendosjes	22
7.1.	Të aprovuara	22
7.2.	Pjesërisht të aprovuara	22
7.3.	Të refuzuara	22
7.4.	Të hedhura poshtë	22
7.5.	Të shpallura jo-kompetent	22
7.6.	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	22
7.7.	Kthimi në rishqyrtim	23
7.8.	Përfundim i procedimit administrativ	23
8.	Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve	24
8.1.	Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore	24
8.2.	Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale	26
9.	Zbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit	28
10.	Funksioni i mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil	30
11.	Funksioni i vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues	31
12.	Rekomandimet dhe sfidat e Këshillit	35
13.	Vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil të Republikës së Kosovës	36
14.	Raporti për shpenzimin e buxhetit të Këshillit	42
15.	Bashkëpunimi i Këshillit me institucionet e tjera	44
16.	Krahasimi i punës së Këshillit për vitin 2015 me punën e Këshillit për vitin 2014	46
17.	Aktiviteti i Këshillit në mbrojtjen e vendimeve pranë gjykatave të vendit	50
18.	Rekomandimet për institucionet e administratës publike	51

**Fjalë hyrëse e kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

Paraqitja e raportit për punën e institucionit kryesor për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, është privilegj dhe përgjegjësi në të njëjtën kohë.

Duke marr parasysh të gjitha sfidat dhe vështësitë me të cilat është përballur Këshilli gjatë vitit 2015, është kënaqësi të ju informoj që Këshilli ka arritur që të kryej të gjitha funksionet kushtetuese dhe ligjore për mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal.

Raporti vjetor për vitin 2015 paraqet një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve të Këshillit duke theksuar të arriturat kryesore në vendosjen e autoritetit të Këshillit si dhe ndërtimin e besimit të përgjegjësit e institucioneve dhe tek të gjithë nëpunësit civil.

Ashtu sikurse edhe në vitet paraprake, këto të arritura kanë qenë të mundura vetëm duke ju falenderu punës së përkushtuar të anëtarëve të Këshillit dhe stafit mbështetës të sekretariatit, dhe për këtë arsye shfrytëzoj rastin të falënderoj që të gjithë për angazhimin e tyre për të përmbushur objektivat e Këshillit.

Në raport përfshihen të dhëna për punët e kryera në kuadër të funksionit të zgjidhjes së ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, funksionit të vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues si dhe funksionit të mbikqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, përfaqësimin e Këshillit në procedura gjyqësore, bashkëpunimin e Këshillit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe pjesëmarrjen e Këshillit në konferenca dhe takime të rëndësishme lidhur me proceset reformuese në administratën publike.

Gjatë vitit 2015, përveç kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisve ligjore, Këshilli i ka kushtuar rëndësi të madhe edhe ngritjes së bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, duhet theksuar bashkëpunimin shumë të mirë me Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Administratë Publike, Avokatin e Popullit, Prokurorinë e Shtetit, Institutin e Kosovës për Administratë Publike, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Asociacionin e Komunave të Kosovës si dhe menaxherët e personelit të Zyrës së Kryeministrit dhe të të gjitha ministrive të Qeverisë së Kosovës.

Në kuadër të bashkëpunimit të mirë me institucionet ndërkombëtare, duhet theksuar sidomos bashkëpunimin me OSBE, vizitën që Këshilli i është bërë nga ambasadorja e ambasadës së Finlandës në Kosovë dhe udhëheqësi i njësisë ligjore në Zyrën e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian, takimet me Kryetarin e Kryesisë Shtetërore të Personelit të Turqisë si dhe Avokatin e Popullit të Republikës së Turqisë z. Nihat OMEROGLU, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e administratës publike.

Gjithashtu duhet theksuar që Këshilli ka pasur një bashkëpunim të hapur me mediat elektronike dhe mediat e shkruara, duke ju mundësuar prezencë fizike në çdo organizim të Këshillit si dhe duke ju ofruar qasje në çdo dokument apo informacion të kërkuar.

Anëtarët e Këshillit, do të vazhdojnë të kryejnë punën e tyre në pajtueshmëri të plotë me mandatin kushtetues dhe ligjor për mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal, duke përmbushur objektivën shtetërore për ndërtimin e një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe në shërbim të qytetarit dhe shtetit në përgjithësi.

Me respekt.

**Lulzim ALIAJ**

---

**Kryetar**

**Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për vitin 2015 përmban të dhëna dhe informata të detajuara, për të gjitha aktivitetet dhe punët e kryera nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në raport përfshihen të dhëna për punët e kryera në kuadër të funksionit të zgjidhjes së ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, funksionit të vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues si dhe funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Po ashtu, në këtë raport janë përfshirë edhe aktivitetet e tjera të Këshillit, si përfaqësimi i Këshillit në procedura gjyqësore, bashkëpunimi i Këshillit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe pjesëmarrja e Këshillit në konferenca dhe takime të rëndësishme lidhur me proceset reformuese në administratën publike.

Këshilli gjatë vitit 2015, ka arritur që të shqyrtojë dhe vendos në mënyrë meritore për 632 ankesa të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, prej të cilave 613 ankesa të pranuar gjatë vitit 2015 dhe 77 ankesa të cilat janë bartur nga viti 2014 për vendosje në vitin 2015.

Këshilli gjatë vitit 2015, ka vëzhguar 68 procedura të rekrutimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues. Nga 68 procedura të rekrutimit që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar si të rregullta 34 procedura të rekrutimit, ndërsa për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale, janë anuluar 34 procedura të rekrutimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues.

Në kuadër të funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit në pajtim me Planin e Monitorimit, Këshilli ka realizuar 41 vizita monitoruese për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Në raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për institucionet e nivelit qendror dhe lokal, Këshilli ka evidentuar dhe ka konstatuar 226 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë 179 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

Këshilli, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, ka punuar me kapacitete pothuajse të përgjysmuara sepse në këtë periudhë detyrën e kanë ushtruar vetëm katër anëtarë, derisa Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 07.04.2015 respektivisht me datë 04.06.2015 ka emëruar edhe 3 anëtarët e rinjë të Këshillit, duke e kompletuar përbërjen e Këshillit në pajtim me Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli gjatë tërë periudhës raportuese, si edhe në vitet e mëparshme është përballur me mungesë të hapësirave për punë, hapësirave për mbajtjen e mbledhjeve, seancave profesionale apo seancave dëgjimore si dhe me mungesën e buxhetit të mjaftueshëm, të cilat sfida pritet të përcillen edhe në vitin 2016.

## 2. KORNIZA LIGJORE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kryen funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
- Ligjin nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
- Ligjin nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
- Ligjin nr.02/L-028 për Procedurën Administrative,
- Rregulloren nr.01/2014 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
- Rregulloren nr. 02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe
- Rregulloren Nr.01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civil të Nivelit Drejtues.

Vështirësitë që kryesisht është përballur Këshilli, e që ndërlidhen me bazën ligjore, përfshijnë mosmiratimin e të gjitha akteve nënligjore për shërbimin civil, kolizionin e dispozitave ligjore në mes të ligjeve por edhe në mes të akteve nënligjore, paqartësitë e krijuara me kategoritë e nëpunësve civilë dhe nëpunësve tjerë në mungesë të përfundimit të klasifikimit të vendeve të punës si dhe moszbatimin e obligimeve ligjore për organizimin dhe strukturimin e administratës shtetërore.

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, është evidente mungesa e vullnetit të udhëheqësve të disa institucioneve për zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil duke u arsyetuar me dispozita të ligjeve të tjera siç është rasti me përgjegjësit e Policisë së Kosovës, Gjykatës Kushtetuese, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Administratës Tatimore, Inspektoratit Policor të Kosovës.

### 3. FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT

Këshilli është organ i pavarur i cili mbikëqyr respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës dhe për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është paraparë me nenin 101 paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me Ligjin Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë përcaktuar funksionet e Këshillit si në vijim:

- shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e shërbimit civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli mund të:

- vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- ketë qasje dhe t'i kontrollojë të dhënat me shkrim lidhur me punësimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avancimin e nëpunësve civilë ose lidhur me shqyrtimin dhe vendimet për ankesa;
- intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

### 4. ORGANIZIMI I KËSHILLIT


Organizimi i brendshëm i Këshillit është i rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe me Rregulloren Nr.03/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e këtij Ligji është përcaktuar edhe përbërja e Këshillit, ku përcaktohet që Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, dhe po ashtu që përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor.

Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar me mundësi rizgjedhje. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga anëtarët e Këshillit me mandat dy vjeçar.

Sekretariati i Këshillit i ofron mbështetje Këshillit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore. Sekretariati udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv dhe ka të punësuar 19 nëpunës civil. Në kuadër të Sekretariatit funksionojnë dy departamente: Departamenti për Mbështetje Profesionale dhe Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.

### Organogrami i Këshillit





## 5. AKTIVITETET E KËSHILLIT PËR PERIUdhËN RAPORTUESE-2015

Në vijim të raportit, paraqesim një pasqyrim të plotë të mënyrës së ushtrimit të funksioneve nga Këshilli, respektivisht për procesin e shqyrtimit të ankesave, procesin e vëzhgimit të emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues si dhe për procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë periudhës raportuese **1 Janar -31 Dhjetor 2015**.

### 5.1. FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Këshilli gjatë vitit 2015 ka pranuar gjithësej **613** ankesa të cilat janë parashtruar nga nëpunësit civilë si dhe nga kandidatët për punësim në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli, përveç 613 ankesave të pranuar në vitin 2015, në shqyrtim ka pasur edhe 77 ankesa të cilat janë bartur nga viti 2014 për vendosje në vitin 2015. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që Këshilli gjatë vitit 2015 ka pasur në shqyrtim gjithësej 690 ankesa.

Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore për 632 ankesa, ndërsa 58 ankesa janë bartur për tu vendosur brenda afatit ligjor në vitin 2016.

Ky raport përmban të dhëna statistikore për ankesat e pranuar sipas:

1. objektit të ankesës,
2. strukturës gjinore të ankuesve,
3. strukturës etnike të ankuesve dhe
4. institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë.


#### 5.1.1. Ankesat sipas objektit të ankesës

Në Këshill, janë pranuar ankesa të cilat kanë pasur objekt të ndryshëm të ankimimit. Ndarja e ankesave sipas objektit të ankesës pasqyrohet në numra dhe në përqindje në tabelën në vijim:


Nr.	Objekti i ankesave	Numri i ankesave	Përqindja
1	Kontestim konkursi	153	24.95%
2	Kompensim material	86	14.03%
3	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	83	13.53%
4	Transferim	65	10.60%
5	Vlerësim i punës	41	6.68%
6	Masë disiplinore	41	6.68%
7	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	30	4.89%
8	Shkelje e të drejtës në pagë	30	4.89%
9	Çështje e avancimit	21	3.42%
10	Mos zbatim i vendimit të Komisionit të Ankesave	20	3.26%
11	Pezullim parandalues	19	3.09%
12	Ulje në pozitë	9	1.46%

13	Kundër caktimit të ushtruesit të detyrës	8	1.30%
14	Mos vazhdim i kontratës së punës	4	0.65%
15	Pezullim i dakorduar	3	0.48%
	<b>Gjithsejtë:</b>	<b>613</b>	<b>100%</b>

Tabela nr.1 paraqet ankesat e pranura dhe të ndara sipas objektit të ankesës



Diagrami nr.1 paraqet të dhënat e tabelës nr.1 për ndarjen e ankesave sipas objektit të ankesës.




Vazhdim i diagramit nr.1.

### 5.1.2. Ankesat sipas strukturës gjinore të ankuesve

Nga numri i përgjithshëm i ankesave prej 613 ankesave të arritura në vitin 2015, ndarja sipas strukturës gjinore të ankuesve është si në vijim: ankues meshkuj kanë qenë 436 ose 71.12%, ndërsa ankuese femra kanë qenë 177 ose 28.88%.

Nr.	Ankesat sipas strukturës gjinore	Numri	Përqindja
1.	Meshkuj	436	71.12%
2.	Femra	177	28.88%

Tabela nr. 2 paraqet ankesat e ndara sipas strukturës gjinore të ankuesve.




Diagrami nr.2 paraqet të dhënat e tabelës nr.2 për ndarjen e ankesave sipas strukturës gjinore të ankuesve

### 5.1.3 Ankesat sipas strukturës etnike të ankuesve.

Nga 613 ankesa të pranuar në vitin 2015, nga ankuesit e përkatësisë etnike shqiptare janë pranuar 571 ankesa ose 93.14% e numrit të përgjithshëm të ankesave. Nga ankuesit e përkatësisë etnike serbe janë pranuar 38 ankesa ose 6.19% e numrit të përgjithshëm të ankesave. Nga ankuesit e përkatësisë etnike boshnjake janë pranuar 3 ankesa ose 0.49% e numrit të përgjithshëm të ankesave, si dhe nga ankuesit e përkatësisë etnike turke është pranuar 1 ankesë ose 0.16% e numrit të përgjithshëm të ankesave.

Nr.	Ankesat sipas strukturës etnike të ankuesve	Numri i ankesave	Përqindja
1.	Shqiptar	571	93.14%
2.	Serb	38	6.19%
3.	Boshnjak	3	0.49%
4.	Turq	1	0.16%

Tabela nr. 3 paraqet ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve.




Diagrami nr.3 paraqet të dhënat e tabelës nr.3

#### 5.1.4. Ankesat sipas institucioneve kundër vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa nga nëpunësit civilë dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, të parashtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit, si në vijim: 369 ankesa ose 60.20% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore si dhe 244 ankesa ose 39.80% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale.

Nr.	Ankesat sipas institucioneve kundër vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë	Numri i ankesave	Përqindja
1.	Institucionet e administratës qendrore	369	60.20%
2.	Institucionet e administratës lokale	244	39.80%

Tabela nr. 4 paraqet ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë.



Diagrami nr. 4 paraqet të dhënat e tabelës nr.4

## 6. ANKESAT E PRANUARA KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

### 6.1. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar 369 ankesa kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Nr.	Institucionet e Administratës Qendrore	Numri i ankesave	Përqindja
1	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	34	5.54%
2	Ministria e Infrastrukturës	25	4.08%
3	Ministria e Punëve të Brendshme	23	3.75%
4	Administrata Tatimore e Kosovës	19	3.1%
5	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	17	2.77%
6	Agjencia Kosovare e Privatizimit	16	2.61%
7	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	16	2.61%
8	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	15	2.45%
9	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	14	2.3%
10	Agjencia Pyjore e Kosovës	13	2.12%
11	Ministria e Punëve të Jashtme	12	1.96%
12	Agjencia e Statistikave të Kosovës	12	1.96%
13	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	11	1.8%
14	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	10	1.63%
15	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	10	1.63%
16	Universiteti i Prishtinës	9	1.47%
17	Prokuroria e Shtetit	9	1.47%
18	Policia e Kosovës	9	1.47%
19	Universiteti i Prizrenit	8	1.30%
20	Ministria e Administratës Publike	7	1.14%
21	Ministria e Shëndetësisë	6	0.98%
22	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	6	0.98%
23	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	6	0.98%
24	Ministria e Financave	5	0.81%
25	Biblioteka Kombëtare e Kosovës	4	0.65%
26	Universiteti i Gjakovës	4	0.65%
27	Institucioni i Avokatit të Popullit	4	0.65%
28	Ministria e Drejtësisë	4	0.65%
29	Këshilli i Sigurisë së Kosovës	4	0.65%
30	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	4	0.65%
31	Autoritet tjetër punëdhënës (ndërmarrjet publike)	3	0.49%
32	Teatri Kombëtar i Kosovës	2	0.33%
33	Kuvendi i Republikës së Kosovës	2	0.33%
34	Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës	2	0.33%
35	Ministria për Komunitete dhe Kthim	2	0.33%

36	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik	2	0.33%
37	Inspektorati Policor i Kosovës	2	0.33%
38	Sekretariati i KPMSHCK-së	2	0.33%
39	Ministria e Diasporës	2	0.33%
40	Zyra e Rregullatorit për ujë dhe kanalizim	2	0.33%
41	Shërbimi Korrektues i Kosovës	1	0.16%
42	Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale	1	0.16%
43	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1	0.16%
44	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	0.16%
45	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1	0.16%
46	Agjencia Kosovare e Pronës	1	0.16%
47	Muzeu i Kosovës	1	0.16%
48	Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike	1	0.16%
49	Agjencia kundër Korrupsionit	1	0.16%
50	Agjencia Kadastrale e Kosovës	1	0.16%
51	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare -Prishtinë	1	0.16%
52	Qendra e Studentëve	1	0.16%
	<b>Numri i përgjithshëm i ankesave:</b>	<b>369</b>	<b>60.20%</b>

Tabela nr. 5 paraqet të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, të pranuar në Këshill gjatë vitit 2015.



<b>Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore sipas objektit të ankesës</b>	Kompensim material	Kontestim konkursi	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	Transferim	Masë disiplinore	Ujje në pozitë	Pezullim parandalues	Mos vazhdim i kontratës së punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Kundër caktimit të ushtruesit të detyrës	Vlerësim i punës	Çështje e avancimit	Mos zbatim i vendimit të Komisionit të ankesave	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	Pezullim i dakorduar	<b>Gjithsejtë</b>
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2	1		1			2		1		1	12	13	1		34
Ministria e Infrastrukturës		1		16	1	1	3				1			2		25
Ministria e Punëve të Brendshme	1	14	1	2	2	2			1							23
Administrata Tatimore e Kosovës	6		2	8	2	1										19
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	1			2	6					2	2	2		2		17
Agjencia Kosovare e Privatizimit	1	2	1		1				5			2	1	3		16
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1	7	1			1			4		1			1		16
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		7			5				2	1						15
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	6	2		2	1				1			1	1			14
Agjencia Pyjore e Kosovës			4		1						8					13
Ministria e Punëve të Jashtme	1	5	1	1						2				2		12
Agjencia e Statistikave të Kosovës	5	1		4					1					1		12
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit		5	2	2		1				1						11
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1	4	1	1			3									10
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore		1					1				3			5		10
Universiteti i Prishtinës	1	4	1				3									9
Prokuroria e Shtetit	2	5							2							9
Policia e Kosovës		5		3									1			9
Universiteti i Prizrenit		8														8

Ministria e Administratës Publike		5						1			1				7
Ministria e Shëndetësisë	3			2	1										6
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	1	1			1						1	2			6
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale		2	1					3							6
Ministria e Financave	1		1			1		1				1			5
Universiteti i Gjakovës		2			1							1			4
Biblioteka Kombëtare e Kosovës				4											4
Institucioni i Avokatit të Popullit		4													4
Ministria e Drejtësisë		1	3												4
Këshilli i Sigurisë së Kosovës				1						1		2			4
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës									4						4
Autoritet tjetër punëdhënës		2	1												3
Teatri Kombëtar i Kosovës			2												2
Kuvendi i Republikës së Kosovës	1									1					2
Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës				2											2
Ministria për Komunitete dhe Kthim	1				1										2
Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik		1					1								2
Inspektorati Policor i Kosovës			2												2
Sekretariati i KPMSHCK-së		1						1							2
Ministria e Diasporës		1	1												2
Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe kanalizim												2			2
Shërbimi Korrektues i Kosovës	1														1
Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale				1											1
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1														1
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		1													1
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal													1		1
Agjencia Kosovare e Pronës								1							1

Muzeu i Kosovës			1													1
Autoriteti Rregullativ për Komunikim Elektronik		1														1
Agjencia Kundër Korrupsionit		1														1
Agjencia Kadastrale e Kosovës											1					1
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – Prishtinë			1													1
Qendra e Studentëve				1												1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>37</b>	<b>95</b>	<b>27</b>	<b>53</b>	<b>23</b>	<b>7</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>24</b>	<b>6</b>	<b>21</b>	<b>20</b>	<b>17</b>	<b>25</b>	<b>1</b>	<b>369</b>

Tabela nr.6 paraqet ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, sipas objektit të ankesave.

**6.2. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale**

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar 244 ankesa kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim:

Nr.	Institucionet e administratës lokale	Numri i ankesave	Përqindja
1	Komuna e Prishtinës	61	9.95%
2	Komuna e Parteshit	17	2.77%
3	Komuna e Gjilanit	16	2.61%
4	Komuna e Ferizajt	16	2.61%
5	Komuna e Lipjanit	15	2.45%
6	Komuna e Leposaviqit	15	2.45%
7	Komuna e Gjakovës	13	2.12%
8	Komuna e Mitrovicës	11	1.8%
9	Komuna e Kamenicës	10	1.63%
10	Komuna e Malishevës	6	0.97%
11	Komuna e Obiliqit	6	0.97%
12	Komuna e Klinës	6	0.97%
13	Komuna e Pejës	5	0.81%
14	Komuna e Vitisë	5	0.81%
15	Komuna e Skenderajt	5	0.81%
16	Komuna e Drenasit	5	0.81%
17	Komuna e Kaçanikut	5	0.81%
18	Komuna e Rahovecit	4	0.65%
19	Komuna e Graçanicës	4	0.65%
20	Komuna e Suharekës	3	0.5%
21	Komuna e Shtimes	3	0.5%
22	Komuna e Vushtrrisë	3	0.5%
23	Komuna e Prizrenit	2	0.33%
24	Komuna e Kllkotit	2	0.33%
25	Komuna e Dragashit	2	0.33%
26	Komuna e Podujevës	2	0.33%
27	Komuna e Deçanit	2	0.33%
	<b>Numri i përgjithshëm i ankesave:</b>	<b>244</b>	<b>39.80%</b>

Tabela nr.7 paraqet të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale të arritura në Këshill gjatë vitit 2015.

<b>Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale</b>	Kompensim material	Kontestim konkursi	Ndërpërje e marrëdhënies së punës	Transferim	ujë ne pozite	Masë disiplinore	Kundër anulimit të konkursit	Pezullim Parandalues	Mos vazhdim i kontratës së punës	Kundër caktimit të ushtrimit të detyrës	Shkelje e të drejtës në pagë	Vlerësim i punës	Mos zbatim i vendimit të Komisionit të Ankesave	Te drejta tjera nga marrëdhënia e punës	Pezullim i dakorduar	Gjithsejtë
Komuna e Prishtinës	12	13	32				1							2	1	61
Komuna e Parteshit	2							1			14					17
Komuna e Gjilanit	6	1	2	3		1					1		1	1		16
Komuna e Ferizajt	5	1	1	3		5								1		16
Komuna e Lipjanit	3	8		1				2					1			15
Komuna e Leposaviqit			15													15
Komuna e Gjakovës	1	6				2	1							2	1	13
Komuna e Mitrovicës	3	4												4		11
Komuna e Kamenicës	2	4	2								1			1		10
Komuna e Malishevës		3				1				1				1		6
Komuna e Obiliqit		2		1				3								6
Komuna e Klinës	6															6
Komuna e Pejës		1				1		1			1			1		5
Komuna e Vitisë	2	2	1													5
Komuna Skenderajt	1	3	1													5
Komuna e Drenasit		2	1	2												5
Komuna e Kaçanikut		2			1	1	1									5
Komuna e Rahovecit					2			1						1		4
Komuna e Graçanicës			2		1	1										4
Komuna e Suharekës		1						2								3
Komuna e Shtimes	1	1												1		3
Komuna e Vushtrisë	1	2														3
Komuna e Prizrenit		2														2
Komuna e Klllokotit						2										2
Komuna e Dragashit	1	1														2
Komuna e Podujevës	1	1														2
Komuna e Deçanit											2					2
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>47</b>	<b>60</b>	<b>57</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>14</b>	<b>1</b>	<b>9</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>14</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>244</b>

Tabela nr.8 paraqet ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave.

## 7. NDARJA E ANKESAVE SIPAS MËNYRËS SË VENDOSJES

Këshilli, gjatë vitit 2015, ka shqyrtuar dhe ka vendosur për gjithsej 632 ankesa, si në vijim:

### 7.1 Ankesat e aprovuara.

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, që në bazë të provave dhe fakteve, Këshilli i ka aprovuar dhe ka anuluar vendimet e organeve të punësimit, duke i obliguar organet e punësimit për zbatimin e vendimeve të Këshillit në afatin e përcaktuar ligjor.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar njëqind e tetëdhjetë e tri (183) ankesa.

### 7.2 Ankesat e aprovuara pjesërisht.

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe për të cilat Këshilli në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit ka vendosur për aprovimin e pjesërishtëm të ankesës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar pjesërisht dhjetë (10) ankesa.

### 7.3 Ankesat e refuzuara.

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka refuzuar si të pabazuara në bazë të provave dhe fakteve të paraqitura nga ankuesit dhe organet e punësimit, duke lënë në fuqi vendimet e organeve të punësimit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka refuzuar njëqind e dhjetë (110) ankesa.

### 7.4 Ankesat e hedhura poshtë si të palejuara.

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka hedhë poshtë si të palejuara sepse janë parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor për ankimim, apo janë parashtruar nga personat që në bazë të ligjit nuk konsiderohen palë në procedurë.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka hedh poshtë si të palejuara njëqind e gjashtëdhjetë e një (161) ankesa.

### 7.5 Ankesat për të cilat Këshilli është shpallur jo-kompetent.

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit për të cilat Këshilli ka vendosur që të shpallet jo-kompetent, për shkak se ankesat janë parashtruar nga personat të cilët nuk e kanë statusin e nëpunësit civil ose nuk janë kandidat për pranim në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese është shpall jo kompetent për të vendosur për gjashtëdhjetë e shtatë (67) ankesa.

### 7.6 Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ.

Janë vendime me të cilat Këshilli i detyron organet e punësimit, respektivisht komisionet përkatëse për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për të vendosur për ankesën e ankuesit, në rastet kur nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka nxjerr vendime për detyrimin e organeve të punësimit për të vendosur, për nëntëmbëdhjetë (19) ankesa.

**7.7 Kthimi i lëndës në rishqyrtim.**

Janë vendime me të cilat, Këshilli ka vendos për kthimin e lëndës në rishqyrtim tek organet e punësimit për të gjitha rastet kur në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit, Këshilli ka konstatuar se nëse lënda kthehet në rishqyrtim tek organi i punësimit do të evitohen gabimet të cilat nuk konsiderohen si shkelje të rënda procedurale. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për kthimin e lëndës në rishqyrtim për pesëdhjete e një (51) ankesa.

**7.8 Përfundim i procedimit administrativ.**


Janë vendime të cilat Këshilli i nxjerr për të gjitha rastet kur ankuesit i tërheqin ankesat ose kur Këshilli konstaton se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ për tridhjetë e një (31) ankesa.

Në tabelën në vijim paraqitet në mënyrë tabelare, mënyra e vendosjes nga Këshilli për 632 ankesa, numri i ankesave të vendosura si dhe përqindja në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave të vendosura.

Mënyra e vendosjes	Numri i ankesave	Përqindja
Ankesat e aprovuara	183	28.95%
Ankesat e hedhura poshtë si të palejuara	161	25.47%
Ankesat e refuzuara	110	17.40%
Ankesat për të cilat Këshilli është shpallur jo kompetent	67	10.60%
Kthimi i lëndës në rishqyrtim	51	8.06%
Përfundim i procedimit administrativ	31	4.90%
Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	19	3.00%
Ankesat e aprovuara pjesërisht	10	1.58%
<b>Gjithsejtë</b>	<b>632</b>	<b>100%</b>

Tabela nr. 9 paraqet mënyrën e vendosjes së ankesave nga Këshilli, numrin e ankesave sipas mënyrës së vendosjes dhe përqindjen në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave



Diagrami nr. 5 paraqet të dhënat e tabelës nr.9

## 8. FORMAT E VENDOSJES KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

Në këtë pjesë të raportit, paraqiten të dhënat për formën e vendosjes nga Këshilli, lidhur me ankesat e parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale.

### 8.1 Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për **375** ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, gjegjësisht për **329** ankesa të vitit 2015, dhe për **46** ankesa të bartura nga viti 2014 në vitin 2015.



Institucionet e Administratës Qendrore	Ankesat e aprovuara	Ankesat e refuzuara	Ankesat pjesërisht të aprovuara	Ankesat e hedhura poshtë si të palejuara	Shpallja jo kompetent	Kthimi në rishqyrtim	Përfundim i procedimit administrativ	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	Numri i ankesave të shqyrtuara
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	6	9		5	4	12	4		40
Ministria e Punëve të Brendshme	4	12		4	1	2	1		24
Ministria e Infrastrukturës	16	3		3		1			23
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	3	1		13	3				20
Agjencia Kosovare e Privatizimit	2	5		11					18
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	1	6		6				4	17
Ministria e Punëve të Jashtme		6		3		1	2	3	15
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	4		5	5		1			15
Administrata Tatimore e Kosovës	5	2		4	1	1			13
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	6	2			1		2	2	13
Agjencia e Statistikave të Kosovës				6	5		1		12
Agjencia Pyjore e Kosovës		3		2		6			11
Prokuroria e Shtetit	4	3		4					11
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	4	3		1			2		10
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	2			3		3	1	1	10
Policia e Kosovës	5	1		2	1	1			10
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1	2	1	2	1	1	1		9
Universiteti i Prishtinës				5	4				9
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	2	4		1					7
Ministria e Administratës Publike	2	1		1			3		7
Avokati i Popullit	6	1							7
Universiteti i Prizrenit				4			1		5
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1			3	1				5
Ministria e Shëndetësisë				4				1	5
Ministria e Financave		2		2		1			5
Biblioteka Kombëtare e Kosovës				4					4
Ministria e Drejtësisë	1	2		1					4
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës						4			4
Këshilli i Sigurisë së Kosovës	1			3					4
Autoritet tjetër Punëdhënës					3				3
Ministria e Diasporës				1	2				3
Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale		1		1		1			3
Universiteti i Gjakovës	1	1							2
Ministria për Komunitete dhe Kthim	2								2

Organi Shqyrtues i Prokurimit	2								2
Inspektorati Policor i Kosovës	1					1			2
Sekretariati i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës		1		1					2
Shërbimi Korrektues i Kosovës				2					2
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1				1				2
Autoriteti Rregullativ për komunikime elektronike postare		1		1					2
Universiteti i Mitrovicës	2								2
Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës						1			1
Teatri Kombëtar i Kosovës					1				1
Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim								1	1
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural				1					1
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1								1
Muzeu i Kosovës				1					1
Agjencioni Kadastral i Kosovës	1								1
Agjencia Kosovare e Pronës		1							1
Qendra e Studentëve	1								1
Kuvendi i Kosovës				1					1
Komisioni për Miniera dhe Minerale	1								1
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>89</b>	<b>73</b>	<b>6</b>	<b>111</b>	<b>29</b>	<b>37</b>	<b>18</b>	<b>12</b>	<b>375</b>

Tabela nr.10 paraqet format e vendosjes për ankesat e shqyrtuara dhe të vendosura gjatë vitit 2015 kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

## 8.2 Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për **257** ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale, gjegjësisht për **226** ankesa të vitit 2015 dhe për **31** ankesa të bartura nga viti 2014 në vitin 2015.

<b>Institucionet e Administratës Lokale</b>	<b>Ankesat e aprovuara</b>	<b>Ankesat e refuzuara</b>	<b>Ankesat pjesërisht të aprovuara</b>	<b>Ankesat e hedhura poshtë si të palejuara</b>	<b>Shpallja jo kompetent</b>	<b>Kthimi në rishqyrtim</b>	<b>Përfundim i procedimit administrativ</b>	<b>Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ</b>	<b>Numri i ankesave të shqyrtuara</b>
Komuna e Prishtinës	32	13		11	1	2	2	1	62
Komuna e Leposaviqit				1	20				21
Komuna e Ferizajit	6	3		4	4			1	18
Komuna e Gjilanit	3	4		8	1	1			17
Komuna e Parteshit	6			3	2	6			17
Komuna e Lipjanit	7			2		1	4	2	16
Komuna e Gjakovës	6	3		2	3		1		15
Komuna e Mitrovicës	2	2	2	2	2	1			11
Komuna e Kamenicës	4		1	4					9
Komuna e Kaçanikut	4	2			1	1			8
Komuna e Pejës	3		1		1		1	1	7
Komuna e Obiliqit	1	3		2					6
Komuna e Malishevës	2	2		1			1		6
Komuna e Klinës		2			1		3		6
Komuna e Vitisë	2			1	2			1	6
Komuna e Skenderajt	3			2					5
Komuna e Drenasit	1	2		1				1	5
Komuna e Dragashit	1			2					3
Komuna e Graçanicës	1			1			1		3
Komuna e Vushtrrisë	2			1					3
Komuna e Suharekës						2			2
Komuna e Deçanit				2					2
Komuna e Podujevës	2								2
Komuna e Prizrenit	1	1							2
Komuna e Rahovecit	2								2
Komuna e Shtimes	2								2
Komuna e Klllokotit	1								1
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>94</b>	<b>37</b>	<b>4</b>	<b>50</b>	<b>38</b>	<b>14</b>	<b>13</b>	<b>7</b>	<b>257</b>

Tabela nr.11 paraqet format e vendosjes për ankesat e shqyrtuara dhe te vendosura gjate vitit 2015 kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

## 9. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT

Në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, organet e punësimit që kanë të punësuar nëpunës civil janë të obliguara për zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe duhet të zbatohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që ka nxjerrë vendimin e parë ndaj palës.

Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Organet e punësimit për vitin 2015, kanë pasur obligim ligjor për të zbatuar **263** vendime të Këshillit, gjegjësisht:


- **183** vendime me të cilat janë aprovuar ankesat,
- **10** vendime me të cilat janë aprovuar pjesërisht ankesat,
- **19** vendime me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të nxjerrin aktin administrativ dhe
- **51** vendime me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të rishqyrtojnë vendimet e tyre.

Përkundër faktit që vendimet e Këshillit janë të vendime të formës së prerë në procedurë administrative, nga njoftimet që Këshilli ka pranuar nga organet e punësimit dhe ankuesit rezulton që organet e punësimit kanë zbatuar **221** vendime, ndërsa nuk kanë zbatuar **41** vendime të Këshillit. Gjatë periudhës raportuese, me vendim të gjykatës është shtyer zbatimi i një (**1**) vendimi të Këshillit.

Vendimet e Këshillit për ankesat	Numri i vendimeve	Vendimet e zbatuara	Vendimet e pa zbatuara	Nuk ka kaluar afati për zbatim	Numri i vendimeve të pezulluara me vendim të Gjykatës
Ankesat e aprovuara	183	146	36		1
Kthimi në rishqyrtim	51	47	4		
Detyrim për vendosje	19	18	1		
Ankesat pjesërisht të aprovuara	10	10	0		
<b>Gjithsejtë:</b>	263	221	41	0	1

Tabela nr. 12 paraqet numrin e ankesave, vendimet e zbatuara, vendimet e pazbatuara si dhe vendimet e pezulluara me vendim të gjykatës

### Zbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit



Diagrami nr.6 paraqet të dhënat e tabelës nr.12

Në tabelën në vijim, paraqiten të dhënat për institucionet e administratës publike që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit si dhe numrin e vendimeve të pazbatuara.

Institucionet e administratës qendrore dhe lokale	Numri i vendimeve të pazbatuara
Komuna e Prishtinës	13
Policia e Kosovës	5
Administrata Tatimore e Kosovës	4
Prokuroria e Shtetit	3
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	2
Komuna e Lipjanit	2
Komuna e Podujevës	2
Organi Shqyrtues i Prokurimit	1
Inspektorati i Policisë së Kosovës	2
Ministria e Punëve të Jashtme	1
Komuna e Malishevës	1
Komuna e Gjilanit	1
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	1
Komuna e Vitisë	1
Komuna e Skenderajt	1
Komuna e Gjakovës	1
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>41</b>

Tabela nr.13 paraqet institucionet e administratës publike që nuk kanë zbatuar vendimet e Këshillit si dhe numrin e vendimeve të pazbatuara.

## **10. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL**

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka ushtruar funksionin e mbikëqyrjes në bazë të nenit 10 paragrafit 3 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke mbikëqyrur zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për dosjet e personelit, procedurat e pranimit në shërbimin civil, zëvendësimin e kontratave të nëpunësve civil, pushimet në shërbimin civil, procedurat e avancimit në karrierë të nëpunësve civilë, procedurat e transferimit të nëpunësve civilë, vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civilë, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin civil, procedurat e ndërprerjes, pezullimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës; komisionet disiplinore dhe procedurat disiplinore si dhe për komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave dhe procedurat e ankesave në kuadër të institucioneve të administratës publike qendrore dhe lokale.

Këshilli, me vendimin me numër 292/2015 të datës 30.01.2015, ka aprovuar Planin e Monitorimit për vitin 2015, ku është paraparë monitorimi i shtatëdhjetë e një (71) institucioneve të nivelit qendror dhe lokal.

Në bazë të Planit të Monitorimit, Këshilli ka realizuar katërdhjetë e një (41) vizita monitoruese të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Në raportin e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për Ministrinë e Punëve të Jashtme, janë përfshirë edhe raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për ambasadat e Republikës së Kosovës në Ankara, Berlin dhe Bern.

Në raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për institucione të nivelit qendror dhe lokal, Këshilli ka evidentuar dhe ka konstatuar 226 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë 179 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

## 11. FUNKSIONI I VËZHGIMIT TË PROCEDURËS SË EMËRIMIT TË NËPUNËSVE CIVIL TË NIVELIT DREJTUES

Funksioni i vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues është i përcaktuar me nenin 10 paragrafin 1.2 si dhe nenin 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në pajtim me këto dispozita, Këshilli është kompetent për të vendosur nëse procedura e emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues është zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e përcaktuara me legjislacionin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me këtë dispozitë ligjore, organet e punësimit, janë të obliguara që të njoftojnë Këshillin, për të vëzhguar procesin e avancimit ose të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues.

Këshilli gjatë vitit 2015 ka marrë pjesë në 68 procedura të vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues në Shërbimin Civil të Kosovës.

Pas vëzhgimit të procedurave të emërimeve të nëpunësve civilë të nivelit drejtues, Këshilli gjatë vitit 2015 ka nxjerrë gjithsejtë gjashtëdhjetë e tetë (68) vendime me të cilat ka vlerësuar nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Nga 68 pozita që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar si të rregullta 34 procedura të rekrutimit ndërsa me vendim të Këshillit apo të organit të punësimit janë anuluar 34 procedura të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Në vijim janë paraqitur në mënyrë tabelare, institucionet dhe pozitat e nëpunësve civilë të nivelit drejtues për të cilat Këshilli ka vëzhguar procedurën e emërimit si dhe mënyrën e vendosjes për këto procedura.

Institucioni	Pozitat e nëpunësve civilë të nivelit drejtues	Data e anulimit
1. Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport	1. Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave	28.12.2015
	2. Drejtor i Galerisë Kombëtare të Kosovës	23.11.2015
2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	3. Drejtor i Drejtoratit për Promovimin e Sektorit Privat	24.12.2015
	4. Drejtor i Drejtoratit për Zhvillimin e Sektorit Privat	12.11.2015
	5. Drejtor i Departamentit për Zhvillimin e Sektorit Privat	12.02.2015
	6. Udhëheqës i Departamentit të Tregtisë	06.01.2015

3. Ministria e Punëve të Brendshme	7. Udhëheqës i Divizionit për Bashkëpunim me Organizata Vendore dhe Ndërkombëtare	17.12.2015
4. Presidenca e Kosovës	8. Zëvendësdirjtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie ndërkombëtare	09.12.2015
5. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	9. Drejtor i Departamentit Ligjor	30.11.2015
6. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	10. Udhëheqës i Zyrës së Punës 11. Udhëheqës i Zyrës së Punësimit në Podujevë	12.11.2015 26.01.2016
7. Ministria e Infrastrukturës	12. Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave	05.11.2015
8. Ministria e Zhvillimit Ekonomik	13. Drejtor i Departamentit ligjor 14. Drejtor i Departamentit të Integritet Evropian Koordinim të Politikave Zhvillim Ekonomik 15. Drejtor i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça 16. Udhëheqës i Departamentit të Integritet Evropian Koordinim të Politikave dhe Zhvillim Ekonomik	30.09.2015 20.04.2015 23.04.2015 16.07.2015
9. Shërbimi Sprovues i Kosovës	17. Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	13.10.2015
10. Komuna e Gjakovës	18. Udhëheqës i Muzeut 19. Udhëheqës i Sektorit për Kulturë	16.09.2015 16.09.2015
11. Komuna e Deçanit	20. Udhëheqës i Sektorit të Arsimit 21. Udhëheqës i Sektorit të Arsimit	10.08.2015 15.09.2015
12. Komuna e Mitrovicës	22. Udhëheqës i Njësisë së Komunikimit Publik	14.09.2015
13. Ministria e Administratës Publike	23. Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike 24. Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike 25. Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike	04.03.2015 16.07.2015 03.09.2015
14. Ministria e Drejtësisë	26. Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit	28.08.2015
15. Universiteti i Pejës	27. Drejtor i Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar	31.08.2015
16. Ministria e Financave	28. Drejtor i Departamentit Qendror për Partneritet Publiko Privat 29. Drejtor i Departamentit Ligjor	27.05.2015 06.07.2015
17. Ministria e Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural	30. Drejtor i Departamentit të Pyltariisë	25.03.2015



18. Akademia e Kosovës për Siguri Publike	31. Udhëheqës i Divizionit për planifikim Strategjik	10.03.2015
19. Sekretariati i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për shërbimin civil	32. Drejtor i Departamentit për Mbështetje profesionale	02.03.2015
20. Komuna e Klllokotit	33. Udhëheqës i Sektorit të Arsimit	04.12.2015
21. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	34. Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	18.11.2015

**Tabela nr. 15 paraqet procedurat e rekrutimit për pozitat e nivelit drejtues të cilat për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale, janë anuluar me vendim të Këshillit apo të organit të punësimit 34 procedura të rekrutimit.**

Në tabelën në vijim pasqyrohen procedurat e rekrutimit për pozitat e nivelit drejtues të cilat procedura pas vëzhgimit janë aprovuar nga Këshilli si të procedura të rregullta të rekrutimit.

Institucioni	Pozitat e nëpunësve civilë të nivelit drejtues	Data e aprovimit
1. Komuna e Mitrovicës	1. Drejtor i SHFMU „Mehë Uka” 2. Drejtor i SHFMU „Ismail Qemali” 3. Drejtor i SHFMU „Bedri Gjinaj” 4. Drejtor i SHFMU „Shemsi Ahmeti” 5. Drejtor i SHFMU „Bislim Imeri” 6. Drejtor i SHFMU „Xhevat Jusufi”	14.12.2015
2. Ministria e Punëve të Jashtme	7. Udhëheqës i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare	14.12.2015
3. Komuna e Deçanit	8. Udhëheqës i Sektorit të Arsimit	01.12.2015
4. Ministria e Punëve të Brendshme	9. Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Legjislacionit 10. Drejtor i Drejtoratit për Pajisje me dokumente 11. Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	03.11.2015 21.07.2015 16.06.2015
5. Ministria e mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	12. Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave 13. Drejtor i Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna	24.11.2015 20.04.2015
6. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	14. Udhëheqës i Divizionit për Monitorimin e Zyrave të Punësimit	24.11.2015
7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	15. Drejtor i Departamentit të Tregtisë 16. Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare	17.06.2015 06.11.2015

8. Ministria e Financave	17. Drejtor i Departamentit Qendror për Partneritet Publiko Privat	06.10.2015
	18. Drejtor i Departamentit të Buxhetit	06.10.2015
9. Ministria e Diasporës	19. Udhëheqës i Departamentit për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit e Kulturës në Diasporë	09.09.2015
	20. Udhëheqës i Departamentit të Qendrave Kulturore në Diasporë.	
	21. Udhëheqës i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.	
10. Ministria e Zhvillimit Ekonomik	22. Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informativë	17.09.2015
	23. Drejtor i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça	10.08.2015
	24. Drejtor i Departamentit Ligjor	18.10.2015
11. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	25. Drejtor i Departamentit për Politika Zhvillimore	07.08.2015
12. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	26. Drejtor i Departamentit të Pylltarisë	29.05.2015
13. Agjencia e Statistikave të Kosovës	27. Drejtor i Departamentit të Administratës	22.05.2015
14. Akademia e Kosovës për Siguri Publike	28. Udhëheqës i Divizionit për planifikim Strategjik	10.04.2015
15. Komuna e Prizrenit	29. Drejtor i Shkollës së Mesme-Remzi Ademaj	23.12.2015
	30. Drejtor i Shkollës së Mesme-Ymer Prizreni	
16. Ministria për Kulturë Rini dhe Sport	31. Drejtor i Përgjithshëm i Teatrit Kombëtar të Kosovës	15.12.2015
	32. Drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës „Pjetër Bogdani”	07.09.2015
17. Universiteti i Mitrovicës	33. Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun	28.12.2015
18. Zyra e Kryeministrit	34. Udhëheqës i Arkivës	18.11.2015

**Tabela nr. 16 paraqet procedurat e rekrutimit për pozitat e nivelit drejtues të cilat janë aprovuar nga Këshilli si procedura të zhvilluara në pajtim me legjislacionin.**

## 12. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KËSHILLIT

Edhe pse me probleme të shumta, mungesës së mjeteve financiare, mungesës së hapësirave elementare për punë, e po ashtu edhe mungesës së stafit mbështetës, Këshilli ka arritur që gjatë vitit 2015, të përmbush funksionet kushtetuese dhe ligjore.

Edhe përkundër premtimeve të përfaqësuesve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Qeverisë, respektivisht të Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, problemet dhe vështirësitë, me të cilat është ballafaquar Këshilli, në aspektin buxhetor dhe të hapësirave të punës, ende mbesin të pazgjidhura, gjegjësisht Këshilli, vazhdon akoma të ballafaqohet me vështirësi t'i ushtroj funksionet e veta kushtetuese dhe ligjore.

Për shkak të këtyre vështirësive, Këshillit iu ka pamundësuar përmbushja e Planit të Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal të administratës publike të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim do të paraqesim, disa nga sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar Këshilli gjatë periudhës raportuese që mbulohet në këtë raport.

- **Buxheti i pa mjaftueshëm, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve** - është një nga sfidat me të cilat është përballur Këshilli në të gjitha vitet, e veçanërisht në vitin 2015. Kjo mungesë ka kufizuar në masë të madhe ushtrimin e funksioneve të Këshillit, me theks të veçantë, ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes të zbatimit të parimeve dhe rregullave të shërbimit civil nga institucionet qendrore dhe lokale, si dhe nga përfaqësitë diplomatike jashtë vendit. Si pasojë e kësaj kemi pasur kufizim të mundësive në realizimin e Planit Vjetor të Monitorimit të Këshillit për vitin 2015, respektivisht për shkak të pamundësive buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të detyrueshme, jemi detyruar që të kufizojmë numrin e monitorimeve në organet e punësimit të cilat kanë të punësuar nëpunës civilë.

- **Mungesa e hapësirave të punës** - mungesa e zyrave të mjaftueshme në një pjesë të vogël të ish ndërtesës së Gërmisë në të cilën është vendosur Këshilli, respektivisht akomodimi i 5-6 zyrtarëve në një hapësirë prej 20 m<sup>2</sup>, vështirëson punën e anëtarëve dhe zyrtarëve të Këshillit, në shqyrtimin dhe zgjidhjen efikase të lëndëve, mbajtjen e seancave dëgjimore dhe seancave të kolegjeve për shqyrtimin e ankesave, si dhe mbajtjen e takimeve të Këshillit.

Edhe perkunder premtimeve të përfaqësuesve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Qeverisë, respektivisht të Ministrisë së Administratës Publike si dhe kërkesave të përsëritura nga Këshilli për ofrimin e hapësirave të punës, ende mbetet e pazgjidhur çështja e objektit funksional për Këshillin.

Hapësirat e tanishme të punës nuk përmbushin as kriteret minimale të standardit të përcaktuar për të zhvilluar punën, në mënyrë efikase dhe efektive nga Këshilli.

- **Mosmiratimi i kërkesave buxhetore të Këshillit, për projekte kapitale** - kërkesa e arsyetuar për blerjen e veturave të reja dhe ekonomike, duke pasur parasysh se automjetet që Këshilli, tani ka në shfrytëzim, janë në gjendje tejet të amortizuara (automjete të prodhuara në vitet 1998 deri 2002), dhe të cilat kanë shpenzime enorme të karburanteve, si dhe kosto shumë të lartë të mirëmbajtjes, të cilën nuk e përballon dot një buxhet i vogël siç është buxheti i Këshillit.

Duke marr parasysh vështirësitë e lartëcekura, Këshilli kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që:

1. Me rastin e rishikimit të buxhetit, të marr parasysh sfidat e paraqitura në këtë raport, duke miratuar kërkesat e Këshillit për ngritjen e buxhetit, me qëllim që të realizojmë objektivat e parapara, konform mandatit kushtetues dhe ligjor duke ruajtur pavarësinë institucionale.
2. Të angazhohet që përmes mekanizmave të vetë, të ndikoj tek institucionet kompetente, për sigurimin e objektit dhe hapësirave të punës për Këshillin.

### **13. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I RESPEKTIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE QË RREGULLOJNË SHËRBIMIN CIVIL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Këshilli, duke u mbështetur në të dhënat e grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, gjegjësisht shqyrtimit të ankesave, procesit të vëzhgimit të emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, në institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal, ka arritur që të nxjerrë një vlerësim të përgjithshëm për zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për fushat përkatëse si dhe të paraqes rekomandimet për institucionet kompetente me qëllim të evitimit të shkeljeve të evidentuara.

Poashtu, Këshilli në këtë raport paraqet edhe rekomandimet e përgjithshme për legjislacionin e shërbimit civil, respektivisht të plotësimit dhe ndryshimit të legjislacionit primar dhe sekondar si dhe propozimet për nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për të rregulluar fusha të caktuara brenda shërbimit civil të cilat nuk janë rregulluar me dispozita përkatëse dhe të cilat po shkaktojnë probleme në funksionimin e institucioneve të administratës publike.

Paralelisht me këtë, Këshilli do të pasqyroj edhe problemet dhe sfidat lidhur me kolizionin ligjor me kategoritë e caktuara brenda shërbimit civil, si stafit civil të Gjykatës Kushtetuese, stafit civil të Policisë së Kosovës, stafin e Administratës Tatimore të Kosovës, inspektorët e Inspektoratit Policor të Kosovës, stafit diplomatik në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës si dhe stafit drejtues dhe administrativ të institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese.

Vlerësimi i fushave përkatëse bazohet në numrin e ankesave të pranuar dhe të shqyrtuara, mënyrën e vendosjes lidhur me këto ankesa, të gjeturat dhe rekomandimet nga procesi i monitorimit të institucioneve si dhe procesin e vëzhgimit të emërimit të nëpunësve civilë në pozitat e nivelit drejtues.

## 1. Pranimi në shërbimin civil

Këshilli gjatë vitit 2015 ka shqyrtuar dhe vendosur për 163 ankesa lidhur me procedurat e rekrutimit. Prej këtyre ankesave, Këshilli ka aprovuar 80 ankesa të ankuesve duke i anuluar procedurat e rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Këshilli gjatë vitit 2015 ka marrë pjesë në 68 procedura të vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues. Nga 68 pozita që janë vëzhguar, Këshilli ka anuluar 34 pozita të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale. Këshilli konstaton se është shqetësues fakti që rreth 50% të procedurave të emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues janë anuluar për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale nga institucionet e administratës publike.

Këshilli ka konstatuar se institucionet e administratës publike, nuk kanë arritur në nivel të kënaqshëm të zbatojnë dispozitat e përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me procedurën e rekrutimit dhe pranimi të nëpunësve civilë në shërbimin civil (qoftë përmes procedurave të avancimit, apo procedurave të jashtme të rekrutimit). Në bazë të të dhënave të grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, Këshilli konstaton se shkeljet më të shpeshta gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit, janë si në vijim:

- mos respektimi i afateve për zhvillimin e procedurave të rekrutimit;
- mosmarrja e autorizimit për shpalljen e konkursit nga DASHC/MAP;
- lëshimi i autorizimit për shpallje nga DASHC/MAP me kritere të ndryshme për pozitat e njëjta;
- themelimi i Komisionit Përzgjedhës për Shërbimin Civil (KPSHC) në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- dështimi i KPSHC-së në llogaritjen e përvojës së punës së kandidatëve për pranim në shërbimin civil;
- përgatitja e testit me shkrim dhe me gojë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Këshilli i rekomandon Ministrisë së Administratës Publike që të ndryshoj dhe plotësoj Rregulloren 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil sepse konsideron se duhet të thjeshtësohen procedurat e rekrutimit dhe duhet të shkurtohen afatet e ankimimit lidhur me këto procedura.

Këshilli poashtu ka konstatuar që Ministria e Administratës Publike, ka filluar me zbatimin e sistemit elektronik të miratimit të kërkesave për autorizimin e procedurës së rekrutimit, edhe pse nuk ka bërë asnjë ndryshim apo plotësim të Rregullores 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, për të përcaktuar procedurën dhe hapat e zbatimit të sistemit elektronik të këtij procesi.

Me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Shërbimin Civil duhet të analizohet gjendja dhe mundësia e aplikimit të sistemit të centralizuar të rekrutimit në shërbimin civil sepse ky sistem do të ndikoj pozitivisht në arritjen e standardeve me të larta të pranimi në shërbimin civil në kuptim të pëmbushjes së parimit të meritës dhe parimeve tjera të shërbimit civilë.

## 2. Komisionet disiplinore dhe procedurat disiplinore

Këshilli gjatë vitit 2015 ka shqyrtuar 134 ankesa që kanë të bëjnë me vendimet e Komisioneve Disiplinore, prej të cilave ka aprovuar 28 ankesa, duke shfuqizuar kështu vendimet e Komisioneve Disiplinore, ndërsa ka refuzuar 35 ankesa të ankuesve dhe ka lënë në fuqi vendimet e Komisioneve Disiplinore. Këshilli nuk është lëshuar në shqyrtim lidhur me 71 ankesa, për shkak se ankesat janë hedhur poshtë si të palejuara, apo është shpallur jo-kompetent, ose ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ.

Këshilli, duke u mbështetur në ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2015, ka konstatuar se Komisionet Disiplinore në shumë raste nuk kanë arritur që të zhvillojnë procedurat duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe afatet e përcaktuara, respektivisht nuk kanë arritur që të përcaktojnë saktë masën disiplinore, në proporcion me shkeljet e evidentuara, si dhe në disa raste kanë vendosur jashtë afatit të përcaktuar ligjor, duke bërë që këto vendime të shpallen akte absolutisht të pavlefshme dhe të mos krijojnë asnjë pasojë juridike. Ky fakt, tregon që Komisionet Disiplinore, duhet të jenë më të përgjegjshme për të ushtruar mandatin e tyre, duke u mbështetur në procedura sepse tejkalimi i afatit ligjor për vendosje nga ana e Komisionit, shkakton dëme të pariparueshme për institucionin, duke pas parasysh se shkelësi i supozuar, edhe pse po vërtetohet se ka bërë shkelje, po kthehet në vendin e tij të punës për shkak se Komisioni po e zhvillon procedurën në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara ligjore.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, Këshilli konstaton se shkeljet me të shpeshta gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore, janë si në vijim:

- themelimi i komisionit disiplinor në kundërshtim me nenin 70 të Ligjit për Shërbimin Civil;
- inicimi i procedurës disiplinore nga autoriteti jokompetent;
- mos respektimi i afateve ligjore lidhur me inicimin dhe zhvillimin e procedurës disiplinore;
- shqiptimi i masave disiplinore në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore;
- përgaditja e vendimeve në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative.

Këshilli ka vërejtur se anëtarët e Komisioneve Disiplinore nuk i kanë ndjekur trajnimet e detyrueshme, për çështjet që ndërlidhen me procedurat disiplinore dhe që është urgjente organizimi i trajnimeve për kryesuesit dhe anëtarët e Komisioneve Disiplinore të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale.

## 3. Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave

Këshilli, ka konstatuar se nga numri i përgjithshëm i ankesave që janë shqyrtuar dhe vendosur në vitin 2015, janë aprovuar 183 ankesa dhe pjesërisht janë aprovuar 10 ankesa, duke shfuqizuar kështu vendimet e Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ndërsa janë refuzuar 110 ankesa të ankuesve, duke lënë në fuqi vendimet e Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave.

Këshilli, duke u mbështetur në ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2015, ka konstatuar se themelimi i Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës sa i përket përbërjes së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, sepse Komisioni ka qenë i themeluar mbi bazën e Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Këshilli, duke u mbështetur në ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2015, ka konstatuar se Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në shumë raste nuk kanë arritur që të vërtetojnë drejtë gjendjen faktike dhe ligjore të vendimeve të Komisioneve Disiplinore, rrjedhimisht, nuk kanë arritur që të zhvillojnë procedurat duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe afatet e përcaktuara. Në disa raste, Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave kanë vendosur jashtë afatit të përcaktuar ligjor, duke bërë që këto vendime të shpallen akte absolutisht të pavlefshme dhe të mos krijojnë asnjë pasojë juridike.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, Këshilli konstaton se shkeljet me të shpeshta gjatë zhvillimit të procedurës së ankimimit nga Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, janë si në vijim:

- themelimi i komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në kundërshtim me nenin 82 të Ligjit për Shërbimin Civil;
- mos respektimi i afateve ligjore lidhur me zhvillimin e procedurës ankimore;
- kthimi i lëndës në rishqyrtim në komisionin disiplinor në kundërshtim me procedurën;
- përgaditja e vendimeve në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative.

Ministria e Administratës Publike, duhet të ndërmarrë masat që të ndryshojë dhe plotësojë Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në dispozitat ku përcaktohet përbërja dhe kohëzgjatja e mandatit të kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit, duke qenë në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil.

a

Këshilli ka vërejtur se anëtarët e Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave nuk i kanë ndjekur trajnimet e detyrueshme, për çështjet që ndërlidhen me procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, dhe që është urgjente organizimi i trajnimeve për kryesuesit dhe anëtarët e Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave.

#### **4. Klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil**

Shumica e institucioneve të administratës publike tashmë i kanë dërguar propozimet e tyre Ministrisë së Administratës Publike lidhur me klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, duke u mbështetur në rregulloret e tyre të brendshme si dhe në dispozitat e Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli duke u mbështetur në Raportet e Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjisllacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës publike, ka vërejtur se një numër i vogël i institucioneve prej (5) sosh ende nuk i kanë dërguar propozimet e tyre në MAP lidhur me



klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, dhe mbi këtë bazë, Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka rekomanduar organet e punësimit që të bëjnë përfundimin e klasifikimit të vendeve të punës dhe në afat sa më të shkurtër kohor t'i dërgojnë propozimet në MAP.

Këshilli, vlerëson aktivitetet e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave, por konstaton që nuk kanë arritur që të finalizojnë procesin e klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në shërbimin civil, i cili proces është i domosdoshëm dhe do të mundësoj që të kemi një sistem të standardizuar të pagave si dhe zbatimin e plotë të procesit të vlerësimit të nëpunësve civilë.

## **5. Vlerësimi i kryerjes së punëve**

Këshilli, duke u mbështetur në Raportet e Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionet e administratës publike, ka konstatuar se në 24 institucione të administratës publike, janë gjetur shkelje lidhur me vlerësimin e nëpunësve civilë sepse disa eprorë nuk kanë kryer vlerësimin e kryerjes së punëve së nëpunësve të tyre për vitin kalendarik në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këshilli, ka konstatuar se në shumicën e institucioneve të administratës publike, vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë, ende vazhdon të bëhet në bazë të udhëzimit administrativ të mëhershëm për shkak të vështirësive në zbatim të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë.

Këshilli konstaton se vlerësimi i punës nëpunësve civilë nuk bëhet në pajtim me objektivat dhe aktivitetet e nëpunësve civilë sepse në shumë raste mungojnë planet vjetore të nëpunësve civilë mbi bazën e të cilave do të duhej të kryhej vlerësimi i punës i nëpunësit civilë.

Këshilli konstaton se në shumë raste, vlerësimi i punës së nëpunësve civilë bëhet jashtë afateve të përcaktuara ligjore, dhe në disa raste, është vërejtur se tek pozitat e nivelit drejtues dhe tek pozitat e nivelit të lartë drejtues, vlerësimi i punës së tyre nuk bëhet me vite të tëra.

Këshilli e vlerëson punën e Institutit Kosovar për Administratë Publike që në Planin e tyre vjetor kanë përfshirë organizimin e trajnimeve lidhur me procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë.

## **6. Transferimi i nëpunësve civil**

Këshilli duke u mbështetur në Raportet e Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës publike, si dhe duke u mbështetur në ankesat e shqyrtuara, gjatë vitit 2015, ka konstatuar se në 27 institucione të administratës publike, transferimet janë bërë në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Tek transferimet e përhershme të nëpunësve civilë, shkeljet kryesisht kanë qenë se këto transferime janë bërë pa pëlqimin e nëpunësit civil, që është një nga kushtet që duhet plotësuar



për t'u konsideruar transferimi i përhershëm si transferim i ligjshëm.

Tek transferimet e përkohshme të nëpunësve civil, shkeljet kryesisht kanë qenë sepse këtu transferet janë bërë pa e përcaktuar saktë kohëzgjatjen e transferit të përkohshëm.

## **7. Pushimet në shërbimin civil**

Këshilli, duke u mbështetur në Raportet e Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionet e administratës publike ka konstatuar që procedurat e pushimeve të nëpunësve civilë kryesisht kryhen sipas dispozitave të përcaktuara me Rregulloren Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë. Gjatë vitit 2015, Këshilli ka pasur një numër simbolik prej 9 ankesave që kanë të bëjnë me pushimet e nëpunësve civilë.

Këshilli, po ashtu rekomandon institucionet e administratës publike, që punonjësve të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, të mos u njohin të drejtën për pushime në kundërshtim me rregullat që përcaktojnë të drejtat e punonjësve që ofrojnë shërbime.

## **8. Dosjet e personelit**

Këshilli duke u mbështetur në procesin e monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionet e administratës publike, ka konstatuar se administrimi dhe mirëmbajtja e dosjeve të personelit, janë në përmirësim të standardeve të përcaktuara me ligj. Në vetëm një numër të vogël të institucioneve të administratës publike është vërejtur se dosjet e personelit nuk mbahen në vende të sigurta. Këshilli, ka konstatuar se dosjet e personelit nuk përditësohen në bazë të rregullave për t'ua bashkangjitur dëshmitë për ngritjen dhe zhvillimin profesional individual të nëpunësve civilë. Këshilli, ka udhëzuar-rekomanduar udhëheqësit e burimeve njerëzore që të zbatohet neni 5 paragrafi 2 i Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil të Republikës së Kosovës, dhe që me rastin e rekrutimit të sigurojnë të dhënat për gjendjen civile dhe dosjen penale të kandidatëve të rekrutuar.

#### 14. RAPORTI PËR SHPENZIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT

Buxheti i aprovuar për Këshillin, sipas Ligjit 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, ka qenë në shumën prej **282.303.00 Euro**, kurse buxheti final-SIMFK, ka qenë në shumën prej **278.441.00 Euro**.

Nr	Kategoritë Ekonomike	Buxheti i aprovuar sipas Ligjit 05/L-001	Me rishikim të buxhetit, sipas ligjit nr. 05/L-046	Ndryshimi	Buxheti Final-SIMFK
1	Paga dhe mëditje	226.076.00	222.214.00	3.862.00	222.214.00
2	Mallra dhe shërbime	52.402.00	52.402.00	00	52.402.00
3	Shpenzime komunale	3.825.00	3.825.00	00	3.825.00
4	Shpenzime kapitale	-00	00	00	00
	<b>Totali</b>	<b>282.303.00</b>	<b>278.441.00</b>	<b>3.862.00</b>	<b>278.441.00</b>

Tabela nr. 17 paraqet alokimin e mjeteve sipas kategorive ekonomike

Nga tabela e mësipërme, shihet qartë se ka dallim në mes të buxhetit të aprovuar dhe buxhetit final në të gjitha kategoritë ekonomike.

Në kategorinë ekonomike **Paga dhe Mëditje**, kemi ndryshim prej 3.862.00 €. Ky ndryshim është pasojë e zvogëlimit të shumës së pagave me rishikim të buxhetit, sipas Ligjit me numër 05/L-046.

-Buxheti i aprovuar fillestar për vitin/2015 për **Paga dhe Mëditje** është.....226.076.00 €

-Zvogëlimi i buxhetit për **Paga dhe Mëditje**, sipas Ligjit 05/L-046 është.....3.862.00 €

**-Buxheti final në këtë kategori për vitin 2015..... 222.214.00€**

Në kategorinë ekonomike **Mallra dhe Shërbime** për vitin 2015, buxheti ka mbetur i njëjtë.

Në kategorinë ekonomike **Shpenzime Komunale** për vitin 2015, buxheti ka mbetur i njëjtë.

Gjatë vitit 2015, nga buxheti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli ka shpenzuar në total **99.44%** të buxhetit. Buxheti i shpenzuar në kategoritë ekonomike është si vijon:

**Në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje**, buxheti është shpenzuar në masën prej **99.72%**.

**Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime**, buxheti është shpenzuar në masën prej **99.39%**.

**Në kategorinë ekonomike Shpenzime komunale**, buxheti është shpenzuar në masën **83.33%**.

<b>Nr.</b>	<b>Kodi buxhetor</b>	<b>Buxheti final</b>	<b>Të shpenzuara</b>	<b>Të pa-shpenzuara</b>	<b>Të shprehura në%</b>
<b>1</b>	<b>Paga dhe mëditje</b>	222.214.00	221.601.80	612.20	99.72
<b>2</b>	<b>Mallra dhe shërbime</b>	52.402.00	52.082.48	319.52	99.39
<b>3</b>	<b>Shpenzime komunale</b>	3.825.00	3.187.24	637.76	83.33
<b>4</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	00	00	00	00
	<b>Totali</b>	<b>278.441.00</b>	<b>276.871.52</b>	<b>1.569.48</b>	<b>99.44</b>

Tabela nr. 18 paraqet shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike

## 15. BASHKËPUNIMI I KËSHILLIT ME INSTITUCIONET TJERA

Këshilli gjatë vitit 2015, përveç kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiave ligjore, i ka kushtuar rëndësi të madhe edhe ngritjes së bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Administratë Publike. Po ashtu Këshilli i ka ofruar bashkëpunim të plotë institucionit të Avokatit të Popullit si dhe Ministrisë së Administratës Publike, në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësiave kushtetuese të Këshillit për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në koordinim dhe bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës, në kuadër të zbatimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në institucionet e administratës publike, ka organizuar takimin e përbashkët me Kryetarët e Komunave të Kosovës.

Në kuadër të bashkëpunimit me Institutin Gjyqësor të Kosovës, Kryetari i Këshillit ka ligjëruar në trajnimin me temën „Procedura gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës” me fokus të veçantë procedurën gjyqësore për kontestet nga marrëdhëniet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, i cili trajnim është organizuar në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV) për gjyqtarë dhe prokurorë.

Poashtu Këshilli ka organizuar trajnimin me temën „Funksionet dhe Kompetencat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës” për njëzet e shtatë (27) kandidatët potencial për gjyqtar dhe prokuror, që kanë vijuar trajnimin në Institutin Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli poashtu ka organizuar takim të veçantë me menaxherët e personelit të Zyrës së Kryeministrit dhe të të gjitha ministrive të Qeverisë së Kosovës, për të diskutuar për problemet, sfidat dhe legjislacionin për shërbimin civil.

Në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike, anëtarët e Këshillit kanë ligjëruar në trajnimet për procedurën e rekrutimit, procedurën disiplinore, procedurën e ankesave si dhe për procedurën e vëzhgimit të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues.

Këshilli gjatë vitit 2015, ka pasur një bashkëpunim të mirë me institucionet ndërkombëtare dhe këtu duhet theksuar sidomos bashkëpunimin me OSBE, GIZ dhe me SIGMA.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, duhet theksuar vizitën që Këshilli i është bërë nga ambasadorja e ambasadës së Finlandës në Kosovë znj. Anne HUHTAMÄKI, dhe z. Jouni Lehtimaki, udhëheqës i njësisë ligjore në Zyrën e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian, dhe dakordimi i përbashkët për shkëmbimin e përvojave në mes të Këshillit dhe institucioneve të njëjta në shtetin e Finlandës.

Në kuadër të ngritjes së bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, Këshilli ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me institucionet relevante në Turqi, veqanarisht me Kryetarin e Kryesisë Shtetërore të Personelit, z.Mehmet Ali KUMBUZOĞLU, si dhe Avokatin e Popullit të Republikës së Turqisë z. Nihat OMEROĞLU, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e administratës publike.

Gjithashtu, Këshilli, ka pasur një bashkëpunim të hapur me mediat elektronike dhe mediat e shkruara, duke ju mundësuar prezencë fizike në çdo organizim të Këshillit si dhe duke ju ofruar qasje në çdo dokument apo informacion të kërkuar.

## **16. KRAHASIMI I PUNËS SË KËSHILLIT PËR VITIN 2015 ME PUNËN E KËSHILLIT PËR VITIN 2014**

### **16.1 Funkzioni i shqyrtimit të ankesave**

Në tekstin në vijim do të paraqiten të dhënat për punën e Këshillit për vitin 2015 në krahasim me punën e Këshillit për vitin 2014, në pajtim me kërkesën dhe formatin e raportit të punës.

Në vitin 2015 në Këshill janë pranuar gjithsej 613 ankesa kurse në vitin 2014 në Këshill janë pranuar 689 ankesa. Nga kjo e dhënë, konstatohet që në Këshill gjatë vitit 2015 janë pranuar 76 ankesa më pak sesa në vitin 2014.

Këshilli, gjatë vitit 2015 përveç 613 ankesave të pranuar, në shqyrtim ka pasur edhe 77 ankesa të cilat janë bartur nga viti 2014 për vendosje në vitin 2015. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që Këshilli gjatë vitit 2015 ka pasur në shqyrtim gjithsej 690 ankesa. Këshilli në vitin 2015 ka vendosur në mënyrë meritore për 632 ankesa, ndërsa 58 ankesa janë bartur për tu vendosur në vitin 2016.

Në vitin 2015 organet e punësimit kanë pasur për obligim zbatimin e 263 vendimeve të Këshillit. Nga 263 vendime, në vitin 2015 organet e punësimit kanë zbatuar 221 vendime ndërsa nuk kanë zbatuar 41 vendime. Për 1 vendim gjykata ka vendosur shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Këshillit.

Në vitin 2014 organet e punësimit kanë pasur për obligim zbatimin e 241 vendimeve të Këshillit. Nga 241 vendime, në vitin 2014 organet e punësimit kanë zbatuar 181 vendime ndërsa nuk kanë zbatuar 54 vendime. Gjykata ka vendosur për shtyrjen e ekzekutimit për vetëm tri (3) vendime të Këshillit.

Në vitin 2015 janë zbatuar 40 vendime të Këshillit më shumë se vendimet e zbatuara në vitin 2014.

Nr.	Ankesat/Vendimet	Viti 2014	Viti 2015	Ndryshimi	Krahasimi i ankesave dhe vendimeve në mes të vitit 2014 dhe 2013
1.	Ankesat e pranuar	689	613	-76	Këshilli në vitin 2015 ka pranuar 76 ankesa më pak se në vitin 2014
2.	Ankesat në shqyrtim në Këshill	727	690	-37 ↓	Këshilli në vitin 2015 ka pasur në shqyrtim 37 ankesa më pak se në vitin 2014
3.	Vendimet e Këshillit për ankesa	650	632	-18 ↓	Këshilli në vitin 2015 ka nxjerrë 18 vendime më pak se në vitin 2014
4.	Vendimet e obligueshme për zbatim	241	263	22 ↑	Organet e punësimit në vitin 2015 kanë pasur obligim për zbatimin e 22 vendimeve më shumë se në vitin 2014
5.	Vendimet e zbatuara	181	221	40 ↑	Në vitin 2015 janë zbatuar 40 vendime më shumë se në vitin 2014
6.	Vendimet e pazbatuara	54	41	+13 ↑	Në vitin 2015 ngritje të zbatimit të vendimeve, dhe kanë ngelur pa u zbatuar 13 vendime më pak se në vitin 2014
7.	Ankesat e bartura në vitin vijues	77	58	-19 ↓	Nga viti 2015 në vitin 2016 janë bartur 19 ankesa më pak se nga viti 2014 në vitin 2015

**Tabela nr.19 paraqet krahasimin e ankesave të pranuar, ankesave në shqyrtim si dhe vendimet e nxjerra gjatë vitit 2015 dhe 2014.**

## 16.2. Funkzioni i vëzhgimit të procedurës së rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues

Këshilli gjatë vitit 2015 ka marrë pjesë në 68 procedura të vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues në të cilat kanë qenë 68 pozita. Nga 68 procedura që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar 34 procedura të rekrutimit ndërsa ka anuluar 34 procedura të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Këshilli gjatë vitit 2014 ka marrë pjesë në 44 procedura të vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues. Nga 44 procedura që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar 28 procedura të rekrutimit, ndërsa ka anuluar 16 procedura të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Në bazë të këtyre të dhënave, vërehet që Këshilli në vitin 2015 ka vëzhguar 24 procedura të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues më shumë se në vitin 2014.

Këshilli në vitin 2015 ka aprovuar 6 procedura të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues më shumë se në vitin 2014.

Këshilli në vitin 2015 ka anuluar 18 procedura të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues më shumë se në vitin 2014.

Nr.	Procedura e vëzhgimit	Viti 2015	Viti 2014	Ndryshimi	Krahasimi i procedurës së vëzhgimit
1	Procedurat e vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues	68	44	24	Këshilli në vitin 2015 ka vëzhguar 24 procedura të rekrutimit më shumë se në vitin 2014
2	Procedurat e aprovuara	34	28	6	Këshilli në vitin 2015 ka aprovuar 6 procedura të rekrutimit më shumë se në vitin 2014
3	Procedurat e anuluar	34	16	18	Këshilli në vitin 2015 ka anuluar 18 procedura të rekrutimit më shumë se në vitin 2014

Tabela nr.20 paraqet krahasimin e procedurës së vëzhgimit për vitin 2015 dhe 2014



**16.3. Funkzioni i mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil**

Në vitin 2015 Këshilli ka realizuar katër dhjetë e një (41) vizita monitoruese dhe ka përgatitur raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Në raportet e vitit 2015 të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për 41 institucione të nivelit qendror dhe lokal, Këshilli, ka evidentuar dhe ka konstatuar 226 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë 179 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

Në vitin 2014 Këshilli ka realizuar katër dhjetë e tetë (48) vizita monitoruese.

Në bazë të këtyre të dhënave, vërehet që Këshilli në vitin 2015 ka monitoruar 7 institucione më pak se në vitin 2014.

Këshilli në vitin 2015 për shkak të kapaciteteve dhe mungesës së buxhetit nuk ka arritur të realizojë me shumë vizita monitoruese, ashtu siç e ka objektiv që gjatë vitit 2016 të realizoj 77 vizita monitoruese.

Nr.	Funksioni i mbikëqyrjes	Viti 2015	Viti 2014	Ndryshimi	Krahasimi i procedurës së mbikëqyrjes për vitin 2014 dhe 2015
1	Vizitat monitoruese të realizuara	41	48	-7	Këshilli në vitin 2015 ka monitoruar 7 institucione më pak se në vitin 2014

Tabela nr.21 paraqet krahasimin e procedurës së mbikëqyrjes për vitin 2015 dhe 2014

## **17. AKTIVITETI I KËSHILLIT NË MBROJTJEN E VENDIMEVE NË GJYKATAVE TË VENDIT**

Gjatë periudhës raportuese bazuar në të dhënat që posedojmë, rezulton se Këshilli në kuptim të mbrojtjes së vendimeve të cilat janë atakuar pranë gjykatave të vendit, ka pranuar shtatëdhjetë (70) aktvendime nga Gjykata Themelore e Prishtinës.

Këshilli ka përgatitur 70 përgjigje në paditë e ushtruara kundër vendimeve të Këshillit.

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli ka pranuar 110 Vendime nga gjykatat e vendit, prej tyre 57 aktgjykime, prej të cilave trembëdhjetë (13) aktgjykime kanë obliguar Këshillin që të rishqyrtoj vendimet e tij, ndërsa me 44 aktgjykime gjykatat e vendit kanë vendosur që të vërtetohen vendimet e Këshillit dhe të refuzohen paditë e ushtruara kundër tyre.

Gjithashtu, gjykata në periudhën raportuese ka lëshuar 53 Aktvendime, prej të cilëve janë 19 aktvendime me të cilët është refuzuar kërkesa e institucioneve për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të Këshillit.

Me 34 aktvendime tjera është vendosur për hedhjen poshtë të padive të paditësve, shpalljen jo-kompetent të gjykatave, pezullimin e procedurës apo ndërprerjen e procedurës.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese në kuptim të përfaqësimit të vendimeve të Këshillit, bashkëpunëtorët profesional kanë marrë pjesë në 75 seanca gjyqësore pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës- Departamenti për Çështje Administrative.

## 18. REKOMANDIMET PËR INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në zbatim të funksioneve kushtetuese dhe ligjore për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal të administratës publike të Republikës së Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në këtë pjesë do të përfshijë disa prej rekomandimeve që konsiderohen më të domosdoshme për funksionimin e administratës publike në pajtim me legjislacionin dhe standardet e njohura të administratës publike.

Rekomandimet i adresohen Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë, Ministrisë së Administratës Publike, Ministrisë së Financave si dhe udhëheqësve kryesor të institucioneve të administratës publike të nivelit qendror dhe lokal.

1. Ndërmarrja e të gjitha veprimeve nga Kuvendi dhe Qeveria për zbatimin e të gjitha Vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, edhe përkundër faktit që në vitin 2015 ka pasur veprime që kanë ndikuar në rritjen e zbatimit të vendimeve të Këshillit;
2. Ndërmarrja e të gjitha veprimeve nga Kuvendi, Qeveria dhe Ministria e Administratës Publike, për ndërprerjen e ndryshimit të statusit të nëpunësve civilë me akte ligjore apo nënligjore, përveç rasteve dhe përjashtimeve të përcaktuara me ligjin për shërbimin civil;
3. Eliminimi i problemeve dhe sfidave të ngritura nga udhëheqësit e institucioneve përkatëse lidhur me zbatimin/moszbatimin e legjislacionit për shërbimin civil për kategoritë e caktuara brenda shërbimit civil: stafit civil të Policisë së Kosovës, stafit civil të Gjykatës Kushtetuese, stafin e Administratës Tatimore të Kosovës, inspektorët e Inspektoratit Policor të Kosovës;
4. Eliminimi i kolizionit ligjor dhe paqartësive për statusin, procedurën e rekrutimit dhe kriteret kualifikuese për stafin drejtues dhe administrativ të institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese;
5. Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për shërbimin civil, duke marr parasysh sfidat dhe vështërsitë e evidentuara në zbatim si dhe duke u bazuar në rekomandimet dhe sugjerimet e institucioneve relevante;
6. Shqyrtimi i mundësisë së aplikimit të sistemit të centralizuar të rekrutimit në shërbimin civil;
7. Finalizimi i procesit të klasifikimit dhe miratimi i gradave në shërbimin civil;
8. Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores për procedurën e rekrutimit;
9. Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores për procedurën disiplinore;
10. Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores për procedurën e ankesave;

11. Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil;
12. Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores për transferimin e nëpunësve civilë;
13. Miratimi nga Ministria e Administratës Publike i rregullores për procedurën e angazhimit të nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veqanta dhe ndërprerja e angazhimit të nëpunësve pa procedurë dhe pa kritere;
14. Respektimi i afateve ligjore dhe procedurës për caktimin e ushtruesve të detyrës në pozitat e nivelit drejtues dhe eliminimi i shkeljeve të Ligjit në tejkalimin e afatit 3 muajor për ushtruesit e detyrës, të përcaktuar me nenin 30 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës;
15. Zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me nostrifikimin e diplomave, dhe përfshirja e këtij kriteri në kuadër të kritereve të konkursit,
16. Respektimi i obligimeve ligjore për pezullimin parandalues të nëpunësve civil në pajtim me nenin 69 të Ligjit Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kuadër të mandatit kushtetues dhe ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, gjatë zbatimit të funksionit për shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil, për vëzhgimin e procedurave të avancimit/rekrutimit të pozitave të nivelit drejtues si dhe funksionit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të institucioneve të administratës publike në nivel qendror dhe lokal, ka evidentuar shkeljet e bëra, sfidat dhe mangësitë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi nga nëpunësit civil.

Duke u bazuar në të gjitha të gjeturat dhe konstatimet e Këshillit si dhe duke marr parasysh kërkesat e vazhdueshme nga nëpunësit civil, menaxherët e personelit dhe zyrtarët kryesor administrativ të institucioneve, për trajtimin e mangësive të evidentuara ligjore dhe procedurale, gjithnjë me qëllim të trajnimit dhe aftësimit të nëpunësve civil dhe krijimit të një administrate të përgjegjshme dhe profesionale, Këshilli ka identifikuar fushat në të cilat është e domosdoshme që të organizohen trajnime për nëpunësit civil të nivelit drejtues dhe profesional.

Duke respektuar kompetencat dhe përgjegjësitë e Institutit të Kosovës për Administratë Publike, posaqërisht në identifikimin dhe vlerësimin, në mënyrë periodike të nevojave për aftësimin e nëpunësve civil të Kosovës në nivelin qendror dhe lokal, në hartimin e programeve të përshtatshme të aftësimit që përmbushin nevojat e identifikuara, ofrimin e trajnimeve për aftësimin e nëpunësve civilë në nivelin qendror dhe lokal si dhe në koordinimin e aktiviteteve me institucionet në nivelin qendror dhe lokal, pas takimit të zhvilluar me përgjegjësit e IKAP-it, arsytimit të kërkesës dhe nevojës për organizimin e trajnimeve, Këshilli ka dërguar shkresën

zyrtare tek Instituti i Kosovës për Administratë Publike, me kërkesën për shqyrtimin e mundësisë që në Planin Vjetor të Trajnimeve, të përfshihen trajnimet në fushën e shërbimit civil, si në vijim:

1. E drejta administrative;
2. Procedura e rekrutimit në shërbimin civil;
3. Hartimi i shkresave zyrtare dhe akteve administrative;
4. Procedurat e avancimit në shërbimin civil;
5. Procedurat e transferimit në shërbimin civil;
6. Procedura Disiplinore, ndërprerja, pezullimi dhe përfundimi i mardhënies së punës në shërbimin civil;
7. Procedura e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave në shërbimin civil;
8. Procedurat e rekrutimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues;
9. Rregullimi dhe përmbajtja e dosjeve të personelit të nëpunësve civil;
10. Puna provuese në shërbimin civil;
11. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil;
12. Procedurat e pushimeve të nëpunësve civil.
13. Konflikti administrativ.

Për nevojën e organizimit të trajnimeve të veçanta sipas fushës së propozuar, janë marr parasysh edhe faktet dhe të dhënat e konstatuara gjatë zgjidhjes së më shumë se 600 ankesave, gjatë procesit të monitorimit të institucioneve si dhe gjatë procesit të vëzhgimit të procedurave të rekrutimit. Ka pasur shumë raste kur për shkak të gabimeve, paqartësive apo moszbatimit të saktë të dispozitës ligjore nga zyrtarët apo komisionet përkatëse, Këshilli ka anuluar procedurat e rekrutimit, procedurat e transferimit, dhe poashtu në shumë raste Këshilli ka kthyer në punë shumë nëpunës civilë që kanë bërë shkelje por ndaj të cilëve nuk janë ndërmarr veprimet procedurale disiplinore apo të zgjidhjes së ankesës në pajtim me procedurën dhe ligjin, dhe që të gjitha këto pastaj kanë efekte negative për administratën në përgjithësi por edhe për buxhetin e Republikës së Kosovës.